

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
i  
"BULB LIGHT.AL" Shpk**

**KAPITULLI I**

**Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja**

**Neni 1  
Data e Themelimit dhe Emri**

1.1. Sot me date 04.01.2021 themelohet nga ortakut/ortaket themelues, sipas legjislacionit shqiptar, shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Bulb Light.AL" (ne vijim "Shoqeria"), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk".

1.2. Ortaku/Ortaket i/e Shoqerise ("Ortaku"/"Ortaket") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuote/a.

1.3. Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga :

- fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk".
- numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.
- adresa e regjistruar;
- pasqyrimi i faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, nese aplikohet.
- kapitalin e regjistruar dhe te paguar te Shoqerise.

**Neni 2  
Forma Ligjore**

2.1. Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar"), ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("Ligji per Shoqerite Tregtare").

**Neni 3  
Selia**

3.1. Ne momentin e nenshkrimet te ketij akti, selia e Shoqerise ndodhet ne adresen:

- Rruga "7 Nentori" Nderresa 2 – kateshe, Kati 1 Njesia administrative Kashar, Mezes Tirane Shqiperi.

3.2 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjetër te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikës se Shqiperise.

#### **Neni 4 Kohezgjatja**

4.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

### **KAPITULLI II**

#### **Neni 5 Objekti i Shoqerise**

5.1. Objekti aktivitetit te Shoqerise eshte kryerja e çdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptar, dhe veçanerisht:

- Sherbime, organizime dasmash, festash, korcentesh, ndricimi, foni ne clube dhe evente te tjera festive dhe mediatike. Sherbim reklamash, sherbim DJ.

5.2. Perveç kesaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperme.

#### **Neni 6 Ndryshime**

6.1. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne çdo kohe siç parashikohet ne kete Statut.

### **KAPITULLI III Kapitali Themeltar; Quotat e Kapitalit Themeltar**

#### **Neni 7 Kapitali Themeltar**

7.1. Kapitali i Shoqerise eshte ne total **10,000 (dhjete mije) Leke** i zoteruar teresisht ne 2 (dy) kuota (me tej "Kuotat")

#### **Neni 8 Ortaku/Ortakët dhe Kuota/Kuotat**

8.1. Ne daten e themelimit Shoqeria ka 2 (dy) Ortake te cilet kane nenshkruar dhe zoterojne Kuotat e Shoqerise, si meposhte :

- **Z. Enkel Vladi**, shtetas Shqiptar, i biri i Bajram lindur në Tirane, më 11.08.1972, banues në Rruga Marko Bocari Pll T.I.D shkalla 1 apartamenti 50, Tiranë, mbajtës i Leternjofimit me Nr. Leternjofimi 033794991, Nr personal H20811104L dt.

26/12/2018, zoteron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **5,000 (pese mije) lekë, që përbën 50 (pesedhjetë) % e kapitalit të Shoqërisë “Bulb Light.AL” sh.p.k.;**

- **Z. Tekliz Çela**, shtetas Shqiptar, i biri i Shkumbin, lindur në Tirane, më 19/07/1983, banues në Ali Baushi, Banesa nr. 3 Tirane mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr letërnjoftimi 035809717, Nr. personal I30719051J, dt. 07.02.2020, zotron nje kuotë me vlerë të përgjithshme **5000 (pese mije) lekë, që përbën 50 (pesedhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë “Bulb Light.AL” sh.p.k.;**

## **Neni 9**

### **Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

9.1. Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit per Shoqerite.

9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.

9.3 Rritja e kapitalit do te behet me leshimin e kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlera e tyre do te paguhet plotesisht.

9.4. Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/ret te bejne blerjen e kuotave perkatese apo pjese te tyre dhe ti anulojne ato.

## **Neni 10**

### **Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve**

10.1. Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuota ne Shoqeri.

10.2. Çdo Ortak do te kete te dejta vote ne perpjestim me perqindjen e kontributit te zoteruar prej tij ne kapitalin e Shoqerise dhe qe perfaqesohet nga Kuota e tij ose pjese e Kuotes se tij. Çdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitave ligjore te Ligjit per Shoqerite.

10.3. Ortakut do t'i jepen, pas kerkeses me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.

10.4. Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotes/tave, transferohen tek çdo zoterues i ri per keto Kuota.

10.5. Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaku mban pergjegjesi brenda limitit te vleres se Kuotes qe zoteron. Ortaku nuk mban pergjegjesi mbi vleren e investimit te tij ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata leshojne).

10.6. Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te tij.

## **KREU IV**

### **Asambleja e Ortakeve/Ortaku i Vetem**

#### **Neni 11 Kompetencat**

11.1. Asambleja/Ortaku i Vetem eshte organi vendim marres i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

#### **Neni 12 Mbledhja**

12.1. Asambleja/Ortaku i Vetem duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.

12.2. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

12.3. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjitha aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja/Ortaku i Vetem do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

12.4. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga ortaku pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

12.5. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/Ortakut te Vetem i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

12.6. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/Ortaku i Vetem mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e Administratoreve.

#### **Neni 13 Menyra e Thirrjes**

13.1. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara tij nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

13.2. Asambleja/Ortaku i Vetem mund te mblidhet nga nje prej Administratoreve ose me iniciativen e tij.

13.3. Asambleja/Ortaku i Vetem mblidhet ne seline e Shoqerise, ose ne ambientet e deges se Shoqerise apo ne cdo qytet, province apo shtet tjeter, siç bihet dakord nga Asambleja/Ortaku. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve i njoftohet Ortakut/Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes, se bashku me dokumentat e nevojshme te lidhura me ceshtjet e rendit te dites. Ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem nuk eshte mbledhur/thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem eshte dakort.

13.4. Ortaku gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

13.5. Ortaku ka te drejten te votoje ne perputhje me vleren e Kuotes se zoteruar prej tij ne kapital.

13.6. Vendimet e meposhtme do te merren me nje kuorum prej me shume se  $\frac{1}{2}$  e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:

- vendimet ne lidhje me mos shperndarjen e fitimeve apo/dhe me destinacionin e ndrshem te fitimeve te Shoqerise;
- ndryshimi i Statutit;
- likujdim ose riorganizmin e Shoqerise;
- zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;

Çdo vendim tjeter do te merret me nje kuorum prej me shume se 30% te kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne 51% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje.

13.7. Ortaket do te njoftohen per permbajtjen e axhendes se mbledhjes.

13.8. Administratori duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit per Shoqerite dhe do te regjistrojne te gjitha vendimet e marra ne Regjistrin e Vendimeve.

#### **Neni 14** **Perjashtimi nga e drejta e votes**

14.1. Nje Ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur eshte duke vendosur mbi:

- vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

14.2. Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

## **KREU V** **Administratori/ret**

### **Neni 15** **Administratoreve dhe kompetencat**

15.1. Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume Administrator/re, sipas vendimit te Asamblese/Ortakut te Vetem. Administratori/ret mund te jete i çdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jete rezident ne Shqiperi.

15.2. Ne momentin dhe per qellimin e miratimit te ketij statuti administrator i Shoqerise eshte:

- - **Z. Enkel Vladi**, shtetas Shqiptar, i biri i Bajram lindur në Tirane, më 11.08.1972, banues në Rruga Marko Bocari Pll T.I.D shkalla 1 apartamenti 50, Tiranë, mbajtës i Leternjoftimit me Nr. Leternjoftimi 033794991, Nr personal H20811104L dt. 26/12/2018, i cili emerohet per nje periudhe prej 5 (pese) vjecare, nga data e themelimit te Shoqerise, te percaktuar ne kete dokument. Çdo ndryshim i mepaseshem ne lidhje me emerimin e Administratorit/reve nuk do te konsiderohet si nje ndryshim Statuti.

15.3. Administratori/ret emerohen per nje periudhe prej 5 (pese) vjecare, te rinovueshme. Ne rast te me shume se nje Administratori kompetencat qe do te ushtrohen vecmas nga secili prej Administratoreve, nese ky eshte rasti, do te percaktohen ne vendimin e Asamblese/Ortakut te Vetem qe emeron Administratoret.

15.4. Menjehere pas pranimit te emerimit te tij/tyre, Administratori(et) njohin ne se mardhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Asamblese/Ortakut i Vetem gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre nga puna, ne perputhje me ligjet perkatese.

15.5. Asambleja/Ortaku i Vetem ka te drejte te shkarkoje Administratorin ne cdo moment.

15.6. Nese Administratoret e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, çeshtja do te referohet tek Asambleja/Ortaku i Vetem.

15.7. Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit kane fuqi vepruese, Administratori kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria mund t'u rimbursoje Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Adminsitratorit(eve) ne vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

## **Neni 16**

### **Kompetencat dhe detyrimet e Administratorit/reve**

16.1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) kerkesa/thirrjea e mbledhjes se Asamblese/ Ortakut te Vetem, ne rastet e specifikuara ne nenin 13;
- (ii) menaxhimin e aktivitetit te perditshem tregtar te Shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem;
- (iii) perfaqesimin e Shoqerise me palet e treta;
- (iv) kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;
- (v) pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim tek Asambleja/Ortaku i Vetem;

kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare e Biznesit, kur eshte e nevojshme;

- (vi) raportimin perpara Asamblese/Ortakut te Vetem, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;
- (vii) kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Asambleja/Ortaku i Vetem.

16.2. Administratori mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaku ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaku.

## **Neni 17**

### **Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia**

17.1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nënve 14,15,16,17 e 18 të Ligjit të Shoqërive, administratoret detyrohen:

- (i) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në këtë Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- (ii) të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- (iii) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- (iv) të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
- (v) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm

17.2. Administratoret përgjigjen kundrejt shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprim apo mosveprim është kryer në mirëbesim.

17.3. Në rast të shkeljes së detyrës dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 të këtij neni, Administratori është i detyruar të demshperblejë Shoqërinë, për demet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë Shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të vertetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidarë.

17.4. Në vecanti, Administratori është i detyruar të demshperblejë Shoqërinë, për demet, neqoftese në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë kryen veprimet e mëposhtme:

- (i) i kthen Ortakëve kontributet;
- (ii) i paguan Ortakëve interesa apo dividente;
- (iii) i shperndan asetet Shoqërisë;
- (iv) lejon që Shoqëria të vazhdojë aktivitetin e saj, kur duhet ta kishte parashikuar që kjo e fundit nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet e saj;
- (v) jep hua;

## **KREU VI** **Administrimi Financiar i Shoqërisë**

### **Neni 18**

## **Eksperti Kontabel i Autorizuar**

18.1 Ortaku cakton ekspertin kontabel te autorizuar (auditues) per te dhene sherbimet e tij kudrejt Shoqerise.

18.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## **KREU VII Aktiviteti Shoqerise**

### **Neni 19 Viti ekonomiko-financiar**

19.1. Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

### **Neni 20 Mbajtja e Llogarive**

20.1. Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

### **Neni 21 Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit**

21.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te pasqyrave financiare te aprovuar nga Asambleja/Ortaku i Vetem. Cdo ndryshim ne destinacionin e fitimit do te caktohet nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne perputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme.

21.2. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

(i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;

(ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;

21.3. Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.2 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush kerkesat sipas 22.2, Administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

21.4. Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

## **KREU VIII Modifikimi i Formes Ligjore dhe Prishja**

**Neni 22**  
**Modifikimi i Formes Ligjore**

22.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

22.2. Shoqeria do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit te nevojshme ne Shqiperi per kete qellim.

**Neni 23**  
**Prishja e Shoqerise**

23.1. Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem;
- (iii) me hapjen e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne cdo kohe.

23.2. Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

**KREU IX**  
**Te ndryshme**

**Neni 24**  
**Largimi i Ortakut**

24.1. Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit per Shoqerite Tregtare.

**Neni 25**  
**E drejta e parablerjes**

25.1 Ortaket e shoqerise kane te drejten e parablerjes se kuotave te shoqerise ne rast te shitjes. Kjo e drejte ushtrohet brenda 20 (njetzet) diteve nga marrja e njoftimit me shkrim mbi

qellimin e shitblerjes se kuotave, derguar me poste zyrtare ose mjeteve elektronike ortakeve te tjere.

**Neni 26**  
**Te tjera**

26.1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

**Ortaket**

**ENKEL VLADI**

ENKEL VLADI  


**TEKLIZ ÇELA**

TEKLIZ ÇELA  
